



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:077806  
Datë: 13.06.2024  
Numri i dokumentit: 05818415

**E.nr.715/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve : V.B., M.F., Z.M. dhe S.B., të cilat i përfaqëson av Urim Bajraktari nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve, ushqimit dhe udhëtimit, si dhe të procedurës kontestimore, më datë 13.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.715/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.715/23, të datës 16.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, si dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:077806, të datës 14.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 21.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,795.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.715/23, më datë 13.06.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**